



**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

**BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)**

SHTATOR, 2024

Buletini MuJOR i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin Shtator 2024 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) të cilat krahasohen nga DEKSI, dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara dhe në disa raste edhe astet e dyshuara dhe të konfirmuara.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit shtator 2024 zënë 46.1 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 377.5/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 3.9/100.000 banorë. NJVKSH Berat, Kukës dhe Bulqizë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin shtator 2024 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin shtator 2024 (Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste Shtator 2024	Incidenca shtator 2024 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	11	0.3
Shigelozë (Disenteri bacilare)	22	0.7
Dizenteri amebike	0	0.0
Toksiko-infeksione alimentare	112	3.9
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	10662	372.4
Sëmundje diarreike në total	10807	377.5

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

Varicela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit shtator 2024 janë raportuar në total 35 raste varicelë (incidenca 1.22/ 100.000 banorë) nga të cilat, 16 raste janë të dyshuara dhe 19 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen varicelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 18 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 22 raste, grafiku 1.

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, shtator 2024



3. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit shtator 2024 janë raportuar gjithsej 22 raste me tuberkuloz (TB). Prej të cilave 18 raste janë pulmonare dhe 4 raste ekstrapulmonare.

Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv.

Rastet pulmonare përkatësisht janë: 9 në Tiranë, 1 në Tropojë, 1 në Mat, 1 në Lezhë, 2 në Kukës, 2 në Durrës, 1 në Dibër, dhe 1 në Berat.

Janë 4 raste ekstrapulmonare përkatësisht: 1 në Tiranë, 1 në Shkodër, 1 në Krujë dhe 1 në Dibër.

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

4. Sëmundjet zoonotike

Tabela 2: Shpërndarja e zoonozave në muajin shtator 2024, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciziozë)

	Shtator (raste 2024)	Incidenca (raste/100,000) 2024
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	4	0.14
Leptospirozë	1	0.03


Për muajin shtator janë raportuar 4 raste Bruceloze përkatësisht: 1 në Gjirokastrë, 1 në Dibër, 1 në Shkodër dhe 1 në Kukës. Gjithashtu është raportuar edhe 1 rast i konfirmuar me Leptospirozë nga Tirana.

5. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

5.1 COVID-19


Gjatë muajit shtator 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 201 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin korrik është 7.02 raste /100000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave (shtator 2024)



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 75+ vjeç me incidencë 21.67 raste për 100000 banorë e ndjekur nga grup-mosha 65-74 vjeç me incidencë 18.74 raste për 100000 banorë. Gjatë këtij muaji vërehet një rritje e incidencës në grup-moshën 0-4 vjeç.

Grafiku 3. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive (shtator 2024)



Bashkitë me incidencë më të lartë janë Tepelena, Gjirokastra, Delvina, etj.

Gjatë muajit shtator 2024 janë raportuar 40 raste të shtruara në spital dhe asnjë rast vdekjeje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 21.9% (44 raste) në ISHP dhe 78.1% (157 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve.

5.2 Grip

Gjatë muajit shtator nuk janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive raste të konfirmuara me grip.

6. Sëmundje të tjera

6.1 Infeksioni nga virusi i Nilit Perëndimor (WNV)

Gjatë muajit shtator në vendin tonë janë konfirmuar pranë laboratorit të virologjisë në ISHP 24 raste me WNV.

Grafiku 4. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas fillimit të shenjave, shtator 2024




Tabela 3. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas bashkive

Bashki	Raste të konfirmuara	% e pozitivitetit
Berat	1	4.2
Dimal	1	4.2
Divjakë	2	8.3
Elbasan	1	4.2
Fier	1	4.2

Kavajë	1	4.2
Krujë	1	4.2
Kurbin	2	8.3
Lezhë	1	4.2
Lushnjë	2	8.3
Pogradec	1	4.2
Roskovec	1	4.2
Tiranë	6	25.0
Vlorë	3	12.5
Total	24	100.0

Vërehet se numri më i lartë i rasteve i përket bashkisë Tiranë (25%).

Rastet i përkasin të gjitha moshës mbi 60 vjeç, kryesisht gjinisë mashkull, janë të shtruar në spital ku kanë paraqitur shenja të encefalitit apo meningoencefalitit.

Nga ana e ISHP-së në bashkëpunim me NJVKSH-të dhe bashkitë përkatëse janë marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e transmetimit të sëmundjes.

6.2 Leshmanioza Viscerale

Për muajin shtator 2024 është raportuar 1 rast i konfirmuar në laborator privat me Leshmaniozë Viscerale nga Kurbin.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI